

AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQËRSISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

NENI 1 THEMELIMI

Sot më datë 13.06.2024, unë ortaku i vetëm Erta Çuko e bija e Llaqit dhe e Vasilikës lindur në Lushnje me datë 08.03. 1986 kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Prosperity Builders Alliance” shpk.

NENI 2 BAZA LIGJORE SELIA EMËRTIMI

Shoqëria “Prosperity Builders Alliance” shpk., është themeluar në bazë të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare në veçanti dhe marrëdhëniet tregtare në tërësi në fuqi në RSH-së. Aktiviteti tregtar dhe personaliteti juridik i shoqërisë do të fillojë me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë QKB. Shoqëria do të veprojë në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sipas dispozitave të përcaktuara në këtë statut.

NENI 3 SELIA

Selia e shoqërisë “Prosperity Builders Alliance” shpk., do të jetë në Tiranë në adresën 21 Dhjetori ish Godina e Librit Shkollor Shkalla e Parë Kati i Tretë Tiranë. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut.

NENI 4 EMERTIMI DHE VULA

Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar do të jetë “Prosperity Builders Alliance” shpk., dhe duhet të jetë i dukshëm në të gjitha letrat dhe korrespondencat e shoqërisë. Në rast të ndryshimit të emrit kjo bëhet vetëm me vullnetin e Ortakëve Shoqëria do të ketë vulën e saj të dallueshme në të cilën do të vendoset logo dhe emri i shoqërisë.

NENI 5 OBJEKTI I AKTIVITETIT

Objekti i aktivitetit të shoqërisë do të jetë : Aktivitet në fushën e ndërtimit privat dhe publik. Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore. Rikonstruksione. Ndërtim banesa me skela mbi 8 kate. Ndërtim rruge. Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa



rrugore. Punime Hekurudhore. Ndërtim Ura dhe Vepra arti deri dhe mbi 10 m. Ndërtim ujësjellësish kanalizime, kanale e impiante vaditje. Pastrim i sipërfaqeve urbane, etj. Import - Eksport, me shumicë dhe pakicë artikujve të ndryshëm të konsumit të përgjithshëm dhe të materialeve elektrike, artikuj ushqimore, industriale, karburante, etj. Import - eksport me shumicë e pakicë të lendeve të para, materialeve të ndërtimit, mobileri, pajisjeve, makineri, kancelari si dhe pjesëve të këmbimit për to; Krijimi i agjencive të speditonit, komisionereve, ndërmjetësimi, etj. Si dhe çdo veprimtari tjetër të nevojshme dhe të dobishme për realizimin e qëllimeve sipas objektit të veprimtarisë së shoqërisë. Punime gërmimi në tokë. Ndërtime civile dhe industriale. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaji, metro, pista aeroportuale. Punime nëntokësorë, ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujësjellës, gazsjellës, vepra kullimi e vaditje. Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë. Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime. Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike . Ndërtime për N/stac., kabina. e transformatorë, linja e TN e te mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime për prishjen e ndërtimeve, Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues). Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Barrierra dhe mbrojtje rrugore . Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri. Punime strukturore speciale. Shtresa dhe mbistruktura speciale .Punime mbi shina dhe traversa. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. Tregtim, instalim, mirëmbajtje i matësve të energjisë dhe ujit. Punime montimi në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë. Ndërtime civile industriale me konstruksion metalik, druri, xhami etj. Të gjitha punimet speciale të instalacionit në funksion të ndërtimeve civile e industriale. Shërbime pastrimi të zonave urbane, rurale dhe të ambienteve të brendshme të objekteve. Punime mjedisore, gjelbërimi dhe dekor. Shërbime dezinfektim, deratizim,. Tregtim me shumicë e pakicë i materialeve të ndërtimit të të gjitha llojeve në funksion të ndërtimit e rikonstruksionit të objekteve civile industriale dhe transportimi i tyre. Import export e tregtim i makinerive të renda dhe automjeteve, i pjesëve të tyre të këmbimit. Mobileri, mobilim zyresh. Mobilim hotelesh dhe objekte të ndryshme. Aktivitet në fushën e turizmit , agrobiznesit, hotelierisë, bar - kafe, restorant, si dhe çdo aktivitet tjetër tregtar që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi. Import Eksport, shitje-blerje mallrash të ndryshme, shitje blerje pajisjesh mjekësore produkteve dhe nënprodukteve të tyre. Objekt i këtij aktiviteti do të jetë çdo lloj aktiviteti i ngjashëm lidhur me sa më sipër që do të konsiderohet i vlefshëm nga vetë politika tregtare e shoqërisë dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi që udhëheq fushën e marrëdhënieve të tregtisë së lirë në territorin e RSH-së. Objekti aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshohet në qoftë se Ortaku/Ortakët dëshirojnë kështu . Për modifikimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë Ortakët do të nënshtrohen legjislacionit në fuqi.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 një qind mijë lekë dhe është i përbërë nga 1 kuotë. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është tërësisht i nënshkruar i papaguar, i ndarë në 1 kuotë që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë dhe zotërohet tërësisht nga;

1. Erta Çuko e bija e Llaqit dhe e Vasilikës lindur në Lushnje me datë 08.03. 1986 shtetase shqiptare e cila zotëron 100% të kuotave

NENI 7 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar në para dhe me anë të kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8 TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen nëpërmjet
 - a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) Shitblerjes
 - c) Trashëgimisë
 - d) Dhurimit
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve për sa nuk parashikohet ndryshe në statut
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 9 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë drejtues i shoqërisë dhe është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë si organi i vetëm vendim marrës.

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendim marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b) ndryshimet e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" "d" të kësaj pike



- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- l) çdo çështjeje tjetër të parashikuar në ligj dhe në statut.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

NENI 10

MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin datën orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe i dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se shtatë ditë përpara thirrjes së mbledhjes.
2. Kur asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

NENI 11

KUORUMI

1. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët zotërojnë më shumë se 50 përqind të votave janë të pranishëm personalisht votojnë me shkresë apo me mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88, të këtij ligji.
3. Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, nga data e anulimit të mbledhjes me të njëjtin rend dite.

NENI 12

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e Përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar shpërndarjen e fitimeve riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

- b) ndryshimet e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" "d" të kësaj pike
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- l) çdo çështjeje tjetër të parashikuar në ligj dhe në statut.

NENI 13 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
- c) ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria
- d) dhënien ose jo të për fitimeve të reja

kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi ashtu si dhe ortaku të cilën përfaqëson.

NENI 14 ADMINISTRIMI

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është pesë vjet me të drejtë ripërtëritjeje .Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

2. **Znj. Erta Çuko** emërohet i Administrator i shoqërisë "Prosperity Builders Alliance" shpk.

3. Administratori do të ushtrojë këtë detyrë për një periudhë pesë vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme Statuti i shoqërisë apo marrëveshje të tjera nuk mund të kufizojnë apo përjashtojnë këtë të drejtë. Përveç sa më sipër Administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve .Tagrat e përfaqësimit të Administratorit dhe çdo ndryshim i tyre i njoftohen dhe dorëzohen me shkresë QKB.

NENI 15 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOR/IT/ËVE

Administratori/ët kanë të drejtë dhe detyrohen që

- a) Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare

- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
 - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet por
 - e) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar
 - f) Kryejnë të gjitha veprimet për regjistrimin e ndryshimeve të shoqërisë pranë QKB në përputhje me ligjin.
 - g) Kryejnë çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj dhe statut
 - h) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregimtarë. Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme edhe në rastet kur;
 - Asambleja e përgjithshme thirret pasi sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve
 - Kur shoqëria brenda dy viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri që kanë vlerë më të lartë se pesë përqind të asetëve të shoqërisë që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara
- Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë juridikë publikë apo privatë vendas apo të huaj përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht organeve të tjera të shoqërisë apo ortakëve.
- Administratori ka të drejtë të angazhojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët nëpërmjet akteve ligjore që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsiper pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund të injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna duke pasur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 15 PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

1. Administratori i nënshtrohet të gjitha përgjegjësive të parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
2. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të tretëve, organeve shtetërore, autoriteteve fiskale lokale apo kombëtare si dhe përpara gjykatave të të gjitha shkallëve.
3. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje me dashje të ligjeve, të statutit apo për faje të rënda të kryera gjatë ushtrimit të funksionit të administratorit.
4. Administratori i shoqërisë është përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit dhe kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë.

NENI 17 BILANCI I SHOQËRISË DHE DIVIDENTËT

Brenda gjashtë muajsh nga mbyllja e vitit financiar , Mbledhja e ortakëve miraton bilancin e paraqitur nga administratori
Mbledhja e ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar siç parashikohet në ligj.

NENI 18 EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë atë vjetor dhe atë periodik në përputhje me kontrollet e ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar nga organet e shoqërisë për të kryer një gjë të tillë. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruara që tja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakut për të shqyrtuar dhe miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka

NENI 19 VITI FINANCIAR

Viti financiar i shoqërisë fillon me datë 1 janar dhe përfundon me datë 31 dhjetor. Përfundimisht , viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor të vitit të regjistrimit

NENI 20 DIVIDENTI

Të ardhurat neto (dividendi) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore dhe atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo për likuidimin e pagesave ndaj të tretëve i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakëve.

NENI 21 KONFIDENCIALITETI

1. Personat e punësuar në shoqëri duhet të mos përhapin informacione mbi shoqërinë, mbi kontratat në të cilat ajo është palë si dhe për planet apo qëllimet që ajo ka për të ardhmen.
2. Mos përmbushja e këtij detyrimi i bën vetë përgjegjës personalisht për shkeljen e konfidencialitetit.

NENI 22 DOKUMENTAT E SHOQERISE



1. Të gjithë dokumentet e shoqërisë dhe aktet e bëra nga shoqëria të cilat i adresohen palëve të treta siç janë dëftesat e pagesave, faturat letrat njoftimet dhe publikime të çfarëdoshme duhet të tregojnë qartë emrin e shoqërisë adresën e selisë së saj dhe tipin e shoqërisë shpk.
2. Përveç letrave dhe dokumenteve të zakonshëm aktet e shoqërisë do të jenë të vlefshme vetëm nëse janë të firmosura nga Administratori dhe janë të vulosura me vulën e shoqërisë

NENI 23 LIKUIDIMI

1. Shoqëria do të hyj në procesin e likuidimit me vendim të Asamblesë së përgjithshme për prishjen e saj.
2. Me hapjen e procedurës së falimentimit
3. Për çdo arsye të parashikuar në ligj
4. Për realizimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të caktojë një ose me shumë likuidatore, të cilët do të raportojnë mbi zërat e pasivit ose të aktivitetit të shoqërisë, mbi veprimet që do të ndiqen për likuidimin e saj dhe kohën e kërkuar për këtë. Në fund të këtij procesi, Asambleja vendos për bilancin përfundimtar dhe mbylljen e likuidimit.
5. Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë regjistrohen nga Administratori apo përfaqësuesi i shoqërisë në QKB në përputhje me dispozitat zbatuese të legjislacionit në fuqi .

NENI 24 ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE

Të gjitha konfliktet që mund të lindin midis shoqërisë dhe palëve të treta do të dërgohen për zgjidhje para gjykatës shqiptare kompetente.

NENI 25 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky statut është përpiluar në pesë kopje në gjuhën angleze dhe pesë kopje në gjuhën shqipe secila me të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtë në fuqi ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

ERTA ÇUKO

ERTA ÇUKO

